



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:“ Furnizim Vendorsje, pajisje ndriçimi publik”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31500000-1;

31519200-9;

31521000-4;

VLERA E FONDIT LIMIT:

8,193,900.00 (tetë million e njëqind e nëntëdhjetë e tremijë e nëntëqind) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Konvikteve te Shkollave te Mesme ka hartuarprocesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është **163,878 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH**, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- 2.1.1 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- 2.1.2 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të

njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e fondit limit, 0,4x8,193,900.00=3,277,560.00(tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë)lekë Pa TVSH.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është ”Procedure e hapur e Thjeshtuar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Kriteri sipas pikes 2.2.2 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas parashikimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, germa b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **2,458,170.00 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **8,193,900.00 (tetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind) Lekë pa TVSH** Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar,
 - Aktin e kolaudimit;

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;

- Akt kolaudimi objekti;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posacme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, germa (a)të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose vlera limit ekontrates që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktor ne funksion te kerkesës për të provuar përvojën e mëparshme të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit ka kërkuar që në rastin e paraqitjes së punëve të ngjashme me kontrata bashkëpunimi ku operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë një përqindje të caktuar dhe zëra specifikë të punës në tërësi ka kërkuar si dokumentacion shoqërues dhe ***kontratën e bashkëpunimit dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.*** Sqarojmë se për të vërtetuar faktin nëse ky operator ekonomik përmbush punët e ngjashme të kërkuara ky dokumentacion është i nevojshëm për autoritetin kontraktor. Në mbështetje të Nenit 88 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, aktet ligjore parashikojnë formën dhe dokumentacionin e nevojshëm për të ofertuar si bashkim operatorësh ekonomik (kontrata e bashkëpunimit si dhe percaktohen elementet konkrete qe do të kryejë secili prej operatorëve ekonomik në bashkëpunim). Pra referuar këtij dokumentacioni përcaktohet saktësisht përqindja dhe elementët konkretë në zëra punimesh që operatori ekonomik ka marrë përsipër të realizojë në këtë kontratë duke i krijuar mundësi autoritetit kontraktor të verifikojë dhe vlerësojë nëse punimet e marra përsipër për tu realizuar në këtë kontratë janë të ngjashme me punimet e kontratës objekt prokurimi. Thënë kjo operatori ekonomik mund te plotësojë vlerën në përqindje të punës që kërkohet të realizohet por ndërkohe në kontratën e realizuar në bashkëpunim mund të mos ketë realizuar zëra të ngjashëm me kontratën objekt prokurimi duke mos provuar përvojën e suksesshme për punë të ngjashme.

2.3.2 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

2.3.3 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

2.3.4 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të specifikohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta/pjesët e katalogut/brosurës ose skedave teknike që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur për të ofruar sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to.

Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Katalogët Teknikë janë të rëndësishëm sepse ata ndihmojnë në vërtetimin e përputhshmërisë së mallrave me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Ata sigurojnë një burim të qartë informacioni për shërbimin që Operatori do të ofrojë dhe garantojnë që të dhënat teknike të paisjeve përputhen me specifikimet e nevojshme. Meqenëse çdo prodhues ka mënyrën e vet të organizimit dhe strukturimit të katalogut ose dokumentave teknike, është e rëndësishme që këto

dokumente të përmbajnë emërtimet e saktë të paisjeve dhe specifikimet teknike. Kjo ndihmon në evitimin e keqkuptimeve dhe siguron që mallrat përputhen me specifikimet në mënyrë të qartë dhe efikase.

2.3.5 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **10 (dhjetë)** punonjes të vërtetuar me vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin Prill 2024.

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore / ose Administrata Tatimore për muajin Prill 2024
- b) Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin Prill 2024

Shënim: (Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.5 do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit dhe dokumentacioni provues do të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Gjithashtu kriteri është përcaktuar edhe në mbështetje të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar Neni 40, pika 5, gërma c.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për njëpunësim e te paktën 10 persona është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të realizohen furnizimet dhe punët apo shërbimet që lidhen me to. Po t’I referohemi preventivit, është plotësisht I justifikuar numri I punonjësve.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi **3 (tre) punonjës elektrikistë** të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore/dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

Shënim:(Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, dhe dokumentacioni provues do të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, 40, pika 5 germa c.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe zërave të preventivit objekt i kontratës. Sqarojmë se, punonjësit elektrikistë të kërkuar janë në përputhje të plotë me preventivin duke marrë në konsideratë zërat që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto shërbime/punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të këtë në stafin e tij:

- Minimumi 1(një) Inxhinier Elektrik.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diploma

Argumentimi:Për sa i takon kriteret **2.3.7**, kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues për realizimin e objektit të prokurimit duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Makinë, me vinç, me kosh, min 15m lartësi	1 copë	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme), Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerases/furnizimit, e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi si dhetë shoqërohet me aktin e pronësisë së qeradhenesit. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 8. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Shënim: Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.8 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 40, pika 6, germa ”ç” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë vendosur sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me zërat përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo ze punimi të kësaj vepre sipas preventivit të hartuara nga projektuesi.

Njesia e prokurimit